



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:075797
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05847914

KPPP.nr.1377/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtar Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Banka Për Biznes”, me seli në Prishtinë, Rr.”UÇK” nr.153, kundër debitorëve 1.)SH.P.K. “Visa Elektro” me NRB:71065871, me pronar L.SH., me seli në Mitrovicë Rr.”...” nr...dhe 2.) K.SH. me adresë në Mitrovicë Rr.”...”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.238/18 të datës 27.03.2018, të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi prapësimi i debitorëve 1.)SH.P.K. “Visa Elektro” me NRB:71065871 dhe 2.) K.SH., ndërsa Urdhri përmbartimor P.nr.238/18 të datës 27.03.2018 i lejuar nga përmbartuesi privat Atip Mustafa, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Atip Mustafa, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbartimor me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Kontratës për kredi të biznesit nr.K0516/1401 e datës 12.12.2016, Marrëveshjes mbi Kolateralin (Pengun e luajtshëm) K0516/1401 të datës 12.12.2016, Konfirmimit të Regjistrimit R-20161214-182 e datës 14.12.2016, duke detyruar debitorët t’ia paguajnë borxhin e mbetur në shumë prej 17,822.44 €, me kamatë prej 9.50 % nga dita e parashtrimit të propozimit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, ka urdhëruar të gjitha Institucionet Financiar se në rast se ka mjete atëherë të transferohen përmes llogarisë së veçantë të organit përmbartues me qëllim të përmbjlljes së obligimit. Në rast të mos realizimit me anë të llogarive bankare, të sekuestrohet

kolaterali i debitorëve sipas kontratës së pengut dhe të njëjtat ti dorëzohen kreditorit për ti shitur, që nga çmimi i shitblerjes të përmbushet obligimi i debitorëve.

Kundër urdhrit përmbarimor në afatin e paraparë ligjor prapësim kanë ushtruar debitorët, e kanë kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar urdhrin përmbarimor, ndër të tjerash kanë theksuar se urdhri i lejuar është i pa rregullt sepse nuk ekziston baza juridike, nuk mbështetet në dokumentin e besueshëm dhe nuk ka ndonjë bazë tjetër e cila kishte me arsyetuar lejimin e ekzekutimit. Ka shtuar se nuk dihet saktë se cila është shuma që duhet të përmbushet, afati i mospërmbushjes dhe çfarë baze juridike është llogaritur pagesa e tërë borxhit edhe pse deri më tani në mënyrë të rregullt janë paguar të gjitha ratat e kredisë, kurse rata e fundit me datë 16.12.2022. Konsideron se ky propozim është i pa rregullt ky urdhër për përmbarim është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. I kanë propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe urdhri përmbarimor të anulohet si dhe të detyrohet kreditori ti paguaj shpenzimet e përpilimit të prapësimit.

Kreditori në përgjigje në prapësim i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorëve si të pabazuara, ndër të tjerash ka theksuar se propozimi për përmbarim u parashtrua si rezultat i mos pagesës nga ana e debitorëve për detyrimet të cilat dalin nga kontrata e kredisë. Ka shtuar se debitorët prapësimin e kanë ngritur mbi bazën e hamendësimeve, ku në propozim janë bashkangjitur të gjitha borxhet e kalkuluara. Në përlllogaritjen e obligimeve deri me datën 10.04.2018, kreditori ka negociuar me debitorët të cilët gjatë gjithë kohës kanë kryer obligimet me vonesë dhe deri më tani janë në vonesë 85 ditë. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorëve ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata në ri procedurë duke vepruar sipas sugjerimeve dhe vërejtjeve të Gjykatës Apelit të Kosovës në Aktvendimin Ac.nr.1134/20 të datës 08.04.2021, e pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, si dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore përcaktohet se dokument përbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”* Në anën tjetër, me nenin 27, paragrafi 1 të LPP-së, është përcaktuar se *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, ndërsa me nenin 36 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri”*.

Gjykata vlerësoi se mbi bazën e Kontratës për kredi të biznesit nr.K0516/1401 e datës 12.12.2016, kreditori me debitorët kishte lidhur Marrëveshjes mbi Kolateralin (Pengun e luajtshëm) K0516/1401 të datës 12.12.2016, e cila kontratë është objekt i përbarimit. Gjykata gjeti se kontrata e lartcekur nuk është paraqitur në formën e kërkuar ligjore, respektivisht nuk i është bashkangjitur shkresave të lëndës në formë origjinale apo kopje të noterizuar, siç përcakton neni 38 par. 1 të LPP-së, se: *1. Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit.”*.

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përbarueshmërisë së nxjerrë nga përbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përbarim nga përbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*.

Andaj nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përbarimit P.nr.238/2018 i datës 27.03.2018, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e

tij, ngase propozimit për përbarim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit përbarimor dhe rrjedhimisht propozimi për përbarim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Gjykata mori parasysh se dokumenti përbarimor, përkatësisht Marrëveshjen e pengut mbi bazë e së cilës është lejuar urdhri përbarimor e njëjta mban vulën e kreditorit, mirëpo gjeti se vendosja e vulës së tillë nga ana e kreditorit, të njëjtit dokument nuk ia jep tiparet e dokumentit të vërtetuar nga origjinali, ngase për vërtetësinë e kopjes nga origjinale kompetent është organi noterial dhe atë në kuptim të nenit 47 paragrafi 1 të Ligjit për noterinë.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përbarim, ndërsa organi përbarues - përbaruesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përbarimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata në kuptim të nenit 43, 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1377/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.